



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1330 Prot.

Tiranë, më 19.07.2023

V E N D I M

Nr. 3

**“PËR SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE PËR KANDIDATË NGA RADHËT E AVOKATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Në mbështetje të neneve 20 dhe 118, të ligjit nr.115/2016, datë 03.11.2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 16, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”:

V E N D O S A:

1. Të shpallë dy vende vakante për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe dy vende vakante për anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve.
2. Shpallja e vendeve vakante dhe kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët sipas nenit 19 dhe 117 të ligjit nr. 115/2016, për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, të publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të Avokatit të Popullit dhe të paktën në një gazetë me tirazhin më të lartë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ

